



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr - 030/01- 164/8 dt. 27/05/2020

DATË/A:	27.05.2020
PËR/ZA/TO:	Asamblistët e Kuvendit të Komunës së Drenasit;
NGA/OD/FROM:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës, për përdhën e pandemisë COVID-19 (13.03.2020 - 26.05.2020)



Të nderuar asamblistë të Kuvendit të Komunës së Drenasit,

Duke uruar që kjo gjendje e pandemisë të kalojë sa më parë, me lejon që para jush të shpalos raportin e punës nga data 13.03.2020, respektivisht nga shpallja e Emergjencës së Shëndetit Publik në Republikën e Kosovës.

Komuna e Drenasit, që nga momenti i shpalljes së Emergjencës së Shëndetit Publik në Republikën e Kosovës i ka përcjellë me vëmendje të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke i postuar të njëjtit në ueb faqen e Komunës së Drenasit, në të njëjtën kohë duke bërë thirrje që këto vendime të respektohen në përpikëri, duke mos paragjykuar kushtetutshmërinë e tyre.

Fillimisht me datë 12.03.2020, është formuar Shtabi Emergjent Lokal (Vendimi Nr.01-020/04-13622).

Pastaj, Drejtoria e Shëndetësisë ka nxjerrë vendimin Nr.06-052/01-1942, me datë 16.03.2020 për prioritetet e QKMF-së në Drenas, duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Po ashtu Inspektorati Komunal në vazhdimësi ka mbikëqyr zbatimin e këtyre vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke qenë në teren gjatë gjithë kohës.

Në Komunën e Drenasit nga data 13.03.2020, vendimet e nxjerra që lidhen me gjendjen e krijuar me Covid-19 janë gjithsej 55 vendime (duke përjashtuar vendimet tjera administrative):

1. Me datë 12 Mars 2020, Komuna e Drenasit me vendimin Nr. 01-020/04-13622 ka formuar Shtabin Emergjent Lokal për zbatimin e masave preventive ndaj virusit COVID-19, i cili vendim është plotësuar me anëtarë të rinjë varësisht nga situata.

2. *Aktvendimi Nr.11-530-13527, i datës 12.03.2020, për vetëkarantinim.*
3. *Aktvendimi Nr.11-052/03-13086, i datës 13.03.2020, për kujdestari gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.*
4. *Vendimi Nr.06-052/01-13942, i datës 16.03.2020, për prioritetet e larta për QKMF-në në Drenas.*
5. *Aktvendimi Nr. 11-530-14042, i datës 20.03.2020, për vetëkarantinim.*
6. *Me datë 23.03.2020 është nxjerrë vendimi Nr. 01-400-14080, për orarin e punës për Maketet Ushqimore (vendim në përputhje me Urdhëresën Nr. 01/04, të datës 20.03.2020, për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë Emergjencës së Shëndetit Publik të MEPTINIS-it).*
7. *Aktvendimi Nr.11-530-14082, i datës 24.03.2020, për vetëkarantinim*
8. *Aktvendimi Nr. 11-530-14042, i datës 24.03.2020, për vetëkarantinim*
9. *Propozim Vendimi Nr.01-400/01-14183, i datës 27.03.2020 për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.*
10. *Vendimi Nr.12-400-14188, i datës 27.03.2020, për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.*
11. *Vendimi Nr.05-030/01-14191, i datës 28.03.2020, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, si dhe kujdestarive të barnatoreve.*
12. *Vendim Nr.01-030-14211, i datës 30.03.2020 për emërimin e menaxherit të kontratës për projektin Furnizimi me Pako Emergjente për nevojtarët në Komunën e Drenasit.*
13. *Vendimi Nr.01-030-14251, i datës 31.03.2020, për formimin e Komisionit për shpërndarjen e 600 pakove emergjente për nevojtarët në Komunën e Drenasit.*
14. *Vendimi Nr.01-030/01-142020, i datës 02.04.2020, për formimin e Nënshabit Emergjent në Komunën e Drenasit, i përberë nga Administratoret e vendbanimeve dhe kryesia e tyre.*
15. *Urdhëresa nga Drejtoria e Inspekcionit e datës 02.04.2020 ndaj subjekteve afariste me masat parandaluese ndaj COVID-19, e cila i obligon të gjitha subjektet për zbatimin e tyre brenda kësaj periudhe.*
16. *Vendimi Nr. 01-020-14476, i datës 10.04.2020, për formimin e komisionit për hartimin e paramasës dhe paralogarisë për furnizim me pako emergjente për nevojtarët e komunës së Drenasit.*
17. *Vendimi Nr.01-020/04-14533, i datës 15.04.2020, për formimin e Qendrës Operative Emergjente Lokale.*
18. *Vendimi Nr. 01-020/04-14523, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
19. *Vendimi Nr. 01-020/04-14526, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
20. *Vendimi Nr. 01-020/04-14506, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
21. *Vendimi Nr. 01-020/04-14520, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
22. *Vendimi Nr. 01-020/04-14518, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
23. *Vendimi Nr. 01-020/04-14508, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
24. *Vendimi Nr. 01-020/04-14509, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
25. *Vendimi Nr. 01-020/04-14524, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
26. *Vendimi Nr. 01-020/04-14514, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
27. *Vendimi Nr. 01-020/04-14513, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*
28. *Vendimi Nr. 01-020/04-14511, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.*

29. Vendimi Nr. 01-020/04-14366, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
30. Vendimi Nr. 01-020/04-14515, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
31. Vendimi Nr. 01-020/04-14530, i datës 15.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
32. Vendimi Nr. 01-020/04-14563, i datës 17.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
33. Vendimi Nr. 01-020/04-14558, i datës 17.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
34. Vendimi Nr. 01-020/04-14563, i datës 17.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
35. Vendimi Nr. 01-020/04-14566, i datës 17.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
36. Vendimi Nr. 01-020/04-14574, i datës 17.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
37. Vendimi Nr.01-020/04-14573, i datës 17.04.2020, për formimin e komisionit për shpërndarjen e pakove ushqimore – higjienike për nevojtarët në Komunën e Drenasit.
38. Aktvendimi Nr. 11-530-14584, i datës 19.04.2020, për vetëkarantinim.
39. Aktvendimi Nr. 11-530-14585, i datës 19.04.2020, për vetëkarantinim.
40. Vendimi Nr. 01-020/04-14588, i datës 21.04.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.
41. Vendimi Nr.01-400/01-14689, i datës 22.04.2020, për emërimin e menaxherit të kontratës për projektin Furnizimi me Pako Emergjente për nevojtarët në Komunën e Drenasit.
42. Vendimi Nr.01-020/04-14688, i datës 22.04.2020, për formimin e Komisionit për shpërndarjen e 2,000 pakove emergjente për nevojtarët në Komunën e Drenasit.
43. Propozim Vendimi Nr.01-400/01-14896, i datës 29.04.2020, për lirimin nga taksa komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin 2020.
44. Vendimi për formimin e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndihme me pako ushqimore- higjienike.
45. Vendimi Nr.01-020/04-14935, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 16 prindërit vetushqyes.
46. Vendimi Nr.01-070/01-14850, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 3 punëtorët e pastrimit të objektit të Komunës.
47. Vendimi Nr.01-070/01-14849, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 3 punëtorët e sigurimit fizik të objektit të Komunës.
48. Vendimi Nr.01-070/04-14936, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 3 punëtorët e stafit të HANDIKOS-it.
49. Vendimi Nr.01-020/04-14938, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienik, për 4 pylltarët.
50. Vendimi Nr.01-070/01-14887, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për fokistin e Komunës.
51. Vendimi Nr.01-020/04-14939, i datës 30.04.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 29 anëtarët e Qendrës për Promovimin të Drejtave të Grave në Drenas.
52. Vendimi Nr.01-070/01-14769, i datës 30.04.2020 për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për znj. Mihrije Gjoka.
53. Vendimi Nr. 01-030-15013, i datës 04.05.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.

54. Vendimi Nr.01-020/04-15054, i datës 05.05.2020, për aprovimin e kërkesës për ndihme me nga 1 pako ushqimore dhe higjienike, për 16 Zjarrfikësit e Komunës së Drenasit.

55. Vendimi Nr. 01-030/01-15498, i datës 15.05.2020, për leje të veçantë të qarkullimit.

Vlen të theksohet së Komuna e Drenasit ka formuar Shtabin Emergjent me datë 12.03.2020, një ditë para se të shpallet gjendja Emergjencës së Shëndetit Publik në Kosovë (vendimi Nr. Nr. 01-020/04-13622).

Nënshtabin Emergjent është formuar me datë 02.04.2020 (vendimi Nr. 01-030/01-142020).

Qendrën Operative Emergjente Lokale është formuar me datë 15.04.2020 (vendimi Nr.01-020/04-14533).

Sa për informacionin tuaj, Komuna e Drenasit edhe gjatë periudhës së pandemisë, ka mbajtur mbledhje, duke respektuar në përpikëri rekomandimet e IKSHP-së, pra janë mbajtur gjithsej 28 mbledhje:

1. 10 mbledhje të shtabit emergjent dhe qendrës operative;
2. 12 mbledhje të Bordit të Drejtoreve;
3. 4 mbledhje të Kuvendit të Komunës (duke përfshi mbledhjen e sotme);
4. 2 mbledhje të KKSBS-së.

Ndërsa ajo që është më e rëndësishme, Komuna e Drenasit gjatë kësaj periudhe është kujdesur që të menaxhojë shpërndarjen e donacioneve të ndryshme. Për këtë është krijuar një mënyrë e komunikimi e drejtpërdrejtë me administratorët e vendbanimeve e përmes tyre me përfaqësuesit e lagjes me qëllim të identifikimit të nevojtarëve realë dhe me qëllim të shmangies së përfituesve të dyfishtë apo trefishtë.

Asambleja Komunale me qëllim të menaxhimit të situatës se krijuar pas shfaqjes së COVID-19 ka ndarë shumën prej 229,200.00 Euro, cila kishte për qëllim blerjen e pakove ushqimore dhe higjienike, me qëllim që familjet e zëna ngushtë nga pandemia të ndihmohen. Prej tyre janë shpenzuar 85,000.00 Euro, ku procedurat janë monitoruar nga koleget tuaj asamblist: Znj Forentina Elezi, Z. Petrit Sinani, ndërsa Z. Beqir Kiqina edhe pse është njoftuar me kohë i njëjti ka munguar.

Për këtë qëllim ne kemi krijuar edhe Komisionin i cili është përkujdesur për shpërndarjen e ndihmave.

Në ditët e para pas pandemisë kemi pranuar një donacion prej 200 thasëve miell dhe 400 litrave qumësht e 400 litra lëngje nga ELKOS dhe Devolli të cilat u janë shpërndarë familjeve të cilat kanë qenë në nevojë imediate, të cilat lista i kanë ofruar Administratoret e Vendbanimeve.

Po ashtu kemi shpërnda 50 pako ushqimore dhe higjienike, për banoret të cilët jetojnë në banesat e socialit në Çikatove të Re, donacion nga fondacioni "Jetimet e Ballkanit".

Pastaj kemi shpërndarë 600 pako ndihmë ushqimore dhe higjienike me vlerë prej 30,000.00 Euro, të blera nga buxheti komunal nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e të cilat sipas vlerësimeve tona kanë lehtësuar jetesën e familjeve në nevojë, e cila shpërndarje është bërë sipas listave të ofruara nga Administratoret e Vendbanimeve.

Po ashtu Komuna e Drenasit nga buxheti i saj ka blerë 2.000 pako ushqimore dhe higjienike në vlerë prej 85,000.00 Euro, të cilat po ashtu janë shpërndarë sipas listët së ofruar nga Administratoret e Vendbanimeve.

Pako me përmbajtje të njëjtë në sasi prej 100 njësi kemi pranuar donacion nga *Islamic Relief*, dhe 100 nga kompania *ATC*. Prej kësaj sasi 160 janë shpërndarë për punëtorët shëndetësorë në shenjë falënderimi për kontributin e tyre gjatë pandemisë, ndërsa pjesa tjetër prej 40 pakosh ka shkuar për kompaninë *Pastrimi*.

Pas kësaj kemi pranuar edhe 210 pako donacion nga Feronikeli dhe 200 nga Katari, gjithashtu të njëjtat janë shpërndarë sipas listës së ofruar nga Administratoret e Vendbanimeve.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur shumë donacione miell. Gjatë javës së parë të prillit kemi shpërndarë 1011 thasë miell për të gjithë përfituesit e skemës sociale në Komunën e Drenasit, pastaj me 21 maj, janë shpërnda 907 thasë miell për nevojtarët sipas listave të hartuara nga Administratoret. Totali i miellit duke përfshirë edhe miellin e pakove arrin afërsisht 146 000 kg që i bien afërsisht 3 kg për kokë banori.

Vlen të theksohet se komunikimi me Administratoret e Vendbanimeve ka qenë transparent, në të njëjtin grup ku është zhvilluar komunikimi kanë qenë të përfshirë edhe asamblastët.

Një bashkëpunim të mirë kemi pasur me Kryqin e Kuq, dega në Drenas dhe sipas informacioneve që na kanë përcjellë ata kanë shpërndarë 192 pako ushqimore dhe higjienike dhe 391 pako higjienike.

Kemi përkrahur edhe kategoritë që kanë qenë tepër të ngarkuara me punë ose të marginalizuara si zjarrfikësit, prindërit vetushqyes, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, persona në hemodializë, HANDIKOS-in, banorët që janë të vendosur në banesa të socialit si dhe disa kërkesa tjera specifike.

Me respekt!